



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

---

Numri i lëndës: 2020:907406

Datë: 28.08.2023

Numri i dokumentit: 04621778

Rev.nr.126/23

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Muhamet Rexha dhe Milena Gjeriq, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: Q. O. nga Gj., të cilin e përfaqëson Shabi Isufi avokat në Gj., sipas autorizimit, kundër të paditurve: S. A., I. N., L. H. dhe D. P., të gjithë nga Gj., dy të fundit i përfaqëson Sherif Sherifi avokat në Gj., sipas autorizimit, për anulimin e kontratave dhe vërtetimin e pronësisë, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3865/18, të datës 21.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 07.08.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Pranohet revizioni i paditësit: Q. O. nga Gj., Prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3865/18, i datës 21.11.2022, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.491/10, i datës 18.12.2017 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.491/10, të datës 18.12.2017, është vendosur: I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Q. O. nga Gj., e paraqitur kundër të paditurve S. A., I. N., L. H. dhe D. P., të gjithë nga Gj., me objekt kontesti anulimin e kontratave dhe vërtetimit të pronësisë. II Anulohet kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, e lidhur në mes të S. A. në cilësi të shitësit dhe L. H. në cilësi të blerëses, kontratë kjo e vërtetuar me Vr.nr....., të datës 29.12.2009, në Gjykatën Komunale në

Gj., si dhe kontratën mbi dhurimin e paluajtshmërisë, e lidhur në mes të L. H. në cilësi të dhuratëdhënëses dhe D. P. në cilësi të dhuratëmarrëses, e përpiluar dhe e legalizuar nga noteri H. M. në Gj., LRP.nr....., Ref.nr..... e datës 20.09.2014. III. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Qe. O. nga Gj., me të cilën ka kërkuar që të: Vërtetohet se i njëjti është pronar i ngastrës kadastrale me numër ..., në vendin e quajtur “...”, në sipërfaqe prej 2179 m<sup>2</sup>, Zonë Kadastrale Gj., ngastër kjo e cila evidentohet në emër të të paditurës D. P. nga Gj.. IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3865/18, të datës 21.11.2022, është vendosur: Aprovohet ankesa e të paditurve S. A., I. N., L. H. dhe D. P., të gjithë nga Gj.. Ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan -Departamenti i Përgjithshëm C.nr.491/10, i datës 18.12.2017, në pikën I dhe II, të dispozitivit ashtu që gjykohet si në vijim: Refuzohet në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Q. O. nga Gj., kundër të paditurve S. A., I. N., L. H. dhe D. P., të gjithë nga Gj., me të cilën ka kërkuar që të anulohet kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, e lidhur në mes të S. A. në cilësi të shitësit dhe L.H. në cilësi të blerëses, kontratë kjo e vërtetuar me Vr.nr. ... , e datës 29.12.2009 në Gjykatën Komunale në Gj., si dhe kontrata mbi dhurimin e paluajtshmërisë, e lidhur në mes të L. H. në cilësi të dhuratëdhënëses dhe D. P. në cilësi të dhuratëmarrëses, e përpiluar dhe e legalizuar nga noteri H. M. në Gj., LRP.nr....., Ref.nr.... e datës 20.09.2014. Pika III dhe IV, mbeti e pashqyrtuar.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësi, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovojë revizionin dhe të ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3865/18, të datës 21.11.2022, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.491/10, të datës 18.12.2017, të vërtetojë, ose lëndën ta kthej në rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në revizion nuk ka pasur.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i paditësit është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi më datë 21.01.2010, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, kundër të paditurve, fillimisht për anulim të kontratës së shitblerjes dhe vërtetimin e pronësisë, duke e precizuar më pas si të drejtë parablerje dhe së fundi, me kërkesë, për anulimin e kontratës së shitblerjes, dhe të dhuratës, si dhe vërtetimin e pronësisë.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit, kundër të paditurve, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin C.nr.491/10, të datës 18.12.2017, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje, gjykata ka bërë administrimin e provave edhe atë: kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë të datës 28.08.2006, kontratat

(interne) mbi shitblerjen e paluajtshmërisë të lidhur në mes të Q. O. si shitës dhe A. I. të datës 20.11.2006, S. Sh. të datës 27.04.2007, A. Sh. të datës 25.09.2006, kontratën mbi shitblerjen e lidhur në mes të S. A. si shitës dhe L. H. si blerëse, e vërtetuar pranë Gjykatës Komonale në Gj., Vr.nr...., të datës 24.12.2009; aktvendimin me numër të lëndës/protokolit .... të datës 18.12.2009, certifikatën e pronës UL-... të datës 07.15.2009, certifikatën e pronës UL- ... të datës 12.30.2009, kontratën për dhurimin e paluajtshmërisë LRP.nr...., Ref.nr.... të datës 20.09.2014, aktvendimin nr. .... të datës 30.09.2014, certifikatën e pronës nr...., të datës 09.10.2014, aktgjykimin C.nr.797/2011 të datës 10.10.2011, aktgjykimet C.nr. 694/06 të datës 06.06.2008, Ac.nr. 4379/12 të datës 04.05.2015, Rev.nr.299/09 të datës 07.03.2012, kontratën private mbi shitblerjen e paluajtshmërisë të datës 01.05.2001, marrëveshjen interne të palëve mbi shitblerjen e paluajtshmërisë të datës 03.03.2003, dalja e gjykatës në vendngjarje së bashku me ekspertin gjeodet, konstatimi i gjeodetit B. K. i datës 15.05.2017, dëgjimin e palëve ndërgjyqëse Q. O., I. N., S. A. dhe L. H. në cilësi të palës, dëgjimi i dëshmitarëve A. I. dhe A. Sh.. Gjithashtu ka shtuar se nga shikimi i gjykatës në vendngjarje është vërtetuar se ngastra kontestuese gjendet në lagjen “ ... ”. Ngastra kontestuese është vërtetuar se është ndarë në 4 pjesë, kurse pjesa fillestare përtej ngastrës kontestuese shfrytëzohet si rrugë. Ngastra kontestuese është e ndarë në 4 pjesë, ku pjesa e parë e ngastrës faktikisht është e ndarë në pjesën lindore me “...”, kurse në pjesën veriore nuk ka pasur as urë e as tel, kurse në pjesën perëndimore ka qenë e rrethuar me tel. Pjesa e dytë e ndarë e ngastrës kontestuese në të gjitha anët ka qenë e rrethuar me tel rrethues, dhe ka pasur të mbjella pemë. Pjesa e tretë e kësaj ngastre të gjitha anët është e rrethuar me tel rrethues dhe në këtë pjesë ka pasur të ndërtuar një objekt gjysmë të përfunduar si dhe në një pjesë ka pasur të mbjellë pemë. Pjesa e katërt e ngastrës kontestuese është e rrethuar në të gjitha anët dhe në këtë pjesë ka të mbjella pemë dhe aty ka pasur të vendosur një objekt të karakterit të përkohshëm (...). Pjesa e fundit e kësaj ngastre në pjesën lindore (ngjitur në pjesën e katër) është rrethuar me tel, kurse pjesa veriore është e kufizuar me murin e shtëpisë të fqinjit, kurse në anën perëndimore kufiri nuk është i shënuar fizikisht, d.m.th, nuk ka mur, tel apo kufi, kurse në pjesën jugore gjithashtu nuk ka kufi të shënuar por kufizohet me rrugën të cilën nga kjo ngastër është lëshuar për shfrytëzim të rrugës. Gjithashtu gjykata vendimin e saj e ka mbështetur edhe në ekspertizën e ekspertit gjeodet, i cili më datë 15.05.2017 ka paraqitur konstatimin-ekspertizën, me të cilën i njëjti ka konstatuar se objekt kontesti në këtë çështje është ngastra kadastrale nr...., në sipërfaqe prej 2179 m<sup>2</sup>, e cila evidentohet në emër të D. (R.) P., si pronare e 1/1 pjesë ideale. Kjo sipërfaqe e ngastrës kontestuese është e ndarë në 6 pjesë, ku sipërfaqja prej 260 m<sup>2</sup>, shfrytëzohet nga S. Sh.. Pjesa e dytë është në një sipërfaqe prej 338 m<sup>2</sup> dhe shfrytëzohet nga Sh. K.. Pjesa e tretë ka sipërfaqen prej 234 m<sup>2</sup> dhe shfrytëzohet nga A. I.. Pjesa e katërt ka sipërfaqen prej 484 m<sup>2</sup> dhe shfrytëzohet nga A. Sh.. Pjesa e pestë ka 458 m<sup>2</sup> dhe shfrytëzohet nga Q. O.. Kurse pjesa prej 405 m<sup>2</sup> shfrytëzohet si rrugë e përbashkët për të gjitha pjesët e shënuara më lartë.

Lidhur më mënyrën e vendosjes si në pjesën e parë të dispozitivit pika I dhe II, gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka mbështetur në gjendjen e vërtetuar faktike sipas së cilës ka ardhur në përfundim se: kontrata e shitblerjes e lidhur në mes të S. A. si shitës, dhe L. P. si blerës, e vërtetuar në Gjykatën Komonale në Gj., më shenjën Vrn.nr.... të datës 29.12.2009, nuk është përmbushur obligimi kontraktues, që do të thotë se shitësi nuk ka pranuar çmimin kontraktues dhe nuk i ka dorëzuar në posedim paluajtshmërinë blerëse. Kontrata në fjalë është e lidhur në

mes të N. P. dhe M. N., për çka dhe gjykata vendosi të anuloi kontratën, si pasoj apo rrjedhojë e se cilës anuloi edhe kontratën tjetër mbi dhurimin, për shkak se L. Pa. nuk ka pas raport juridik, dhe nuk ka pas të drejtë ta dhurojë një paluajtshmeri, që nuk ka qenë e saj.

Lidhur me mënyrën e vendosjes si në pjesën e dytë të dispozitivit pika III, gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka mbështetur me arsyetimin se i padituri i dytë I. N. nuk ka pas dhe nuk ka pronësi mbi ngastrat kontestuese, për çka dhe nuk mundë të bartë të drejta më shumë se që ka, si dhe ngastrat në fjalë janë bartë tek personat të tretë ndaj të cilëve nuk ka padi të drejtuar.

Për shpenzimet e procedurës iu ka referuar nenit 450 lidhur me nenin 463 të LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, të paditurit kanë paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.3865/18, të datës 21.11.2022, ka vendosur që të aprovojë ankesën e të paditurve, të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar në pikën I dhe II, të dispozitivit sa i përket pjesës së anulimit të kontratës së shitblerjes të lidhur mes S. A. në cilësi të shitësit dhe L. H. në cilësi të blerëses, kontratë kjo e vërtetuar me Vr.nr. ..., e datës 29.12.2009 në Gjykatën Komunale në Gj., Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të nenit 195 paragrafi 1 pika e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga

arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e pjeshme të kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata e shkallës së parë nuk i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat nuk i ka cituar as si përmbajtje, dhe nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi themelësinë e pjeshme të kërkesëpadisë.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet e palëve duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të bazuara duke e ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Përveç tjerash aktgjykimi i shkallës së parë është marr edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 1 të LPK-së, e lidhur me nenin 99, për arsye se: padia e datës 21.01.2010, ndryshimi i padisë si në seancën gjyqësore të datës 07.11.2014, dhe precizimi i padisë në parashtrësën e datës 14.11.2017, nuk përmban elementet që duhet ti përmbajë çdo parashtrësë, në fakt kërkesa në padi është e paqartë dhe e pakuptueshme dhe se nuk është e specifikuar saktë kërkesa se çka kërkon paditësi në këtë rast. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë, para se të vendosë në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditësit është dashur që padinë e paditësit ta kthejë në korrigjim, në kuptim të nenit 99 dhe 102 e lidhur me nenin 2 paragraf 1 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, tani për tani nuk mund të pranohet përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë dhe as të dytë, për faktin se gjykata e shkallës së parë, gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërteton në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve sipas pretendimeve nga padia, për arsye se gjykata e shkallës së parë ka dështuar të vërtetojë faktet me rëndësi për të vendosur sipas padisë së paditësit, për arsye se: nëse i referohemi pretendimeve të palëve dhe shkresave të lëndës rezulton se të paditurit S. A. dhe L. H., kanë lidhur kontratë për shitblerjen e paluajtshmërisë, të evidentuar me numër Vr.nr..., të datës 29.12.2009 dhe e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gj., ndërsa të njëjtën paluajtshmëri e paditura L. H., me kontratën mbi dhurimin e paluajtshmërisë, të lidhur në mes të L. H. në cilësi të dhuratëdhënëses dhe D. P. në cilësi të dhuratëmarrëses, e përpiluar dhe e legalizuar nga noteri H. M. në Gj., e protokolluar LRP.nr..., Ref.nr.... e datës 20.09.2014, ia bartë pronësinë kësaj të fundit. Ndërsa gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë në shikim shkresat e lëndës sipas kontratës e cila është

objekt kontesti e as kontratave tjera dhe atë: shkresat e lëndës C.nr...., C.nr...., Vr.nr...., Vr.nr..., LRP.nr...., Ref.nr...., e provat e administruara si provë nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë në kopje, gjykata e shkallës së parë edhe pse ka dal në vendshikim për të bërë identifikimin e saktë të pronës kontestuese, në të cilat pala paditëse ka pretenduar se është pronë e tij, gjykata nuk ka arritur që sipas përshkrimit të bërë nga paditësi, të identifikojë saktësisht se cila është paluajtshmëria kontestuese në të cilën ka pretenduar se ka të drejtën e pronësisë, më saktësisht si në kërkesëpadi lidhur me paluajtshmërinë kontestuese, duke e përshkruar saktësisht shtrirjen gjeografike të saj/tyre, gjatësinë dhe gjerësinë, sa është sipërfaqja e saktë e paluajtshmërisë/ve kontestuese dhe cila është gjendja faktike në teren lidhur me atë parcelë/a kadastrale, ekspertiza e ekspertit gjeodet në pjesën e pestë të ngastrës kadastrale e konstaton se e njëjta shfrytëzohet nga tani paditësi, ndërsa gjykata në konstatimin e saj nuk jep sqarime më të theksuara se në çfarë cilësie është paditësi në atë parcelë kadastrale, a është titullar i asaj të drejte apo vetëm shfrytëzues i saj, fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Përveç të cekurave gjykata e shkallës së parë dhe e dytë, nuk i kanë vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i kësaj kanë bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të LPK-së, etj.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, pastaj të caktoj shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, fillimisht të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, pastaj nëse është e nevojshme së bashku me palët apo të autorizuarit e tyre dhe ekspertin gjeodet të dal në vend, ashtu që gjykata sipas përshkrimit të cilin do ta bëjnë palët rreth paluajtshmërisë kontestuese, të udhëzojë ekspertin gjeodet që të bëjë identifikimin, incizimin dhe matjen e saktë të paluajtshmërisë/ve kontestuese. Pas identifikimit dhe matjes së saktë e cila do të bëhet nga eksperti gjeodet, gjykata do duhet ta bëjë përshkrimin e gjendjes faktike në vend dhe pastaj sipas mendimit - raportit me shkrim të cilin eksperti gjeodet do duhej t'ia sigurojë gjykatës, gjykata të ndërmer hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, nga Zyra Komunale Kadastrale në Gj., të kërkohet historiati i pronës për paluajtshmërinë kontestuese, duke mos përjashtuar mundësinë e kërkimit të dhënave edhe nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në P., sipas detyrës zyrtare t'i marrë në shikim shkresat e lëndës dhe atë: C.nr..., C.nr...., Vr.nr...., Vr.nr...., LRP.nr...., Ref.nr...., dëgjimin e dëshmitarëve eventual e në rast nevojë edhe ballafaqimin e tyre, dëgjimin e palëve ndërgjyqëse në cilësi të palës (në kuptim të vërejtjeve të theksuara si më lartë) dhe provave të propozuara nga palët, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ligjit (ligjeve) të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur pretendohet që janë krijuar raportet - juridike në mes të palëve, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësojë rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata sipas revizionit, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2020:907406

Datë: 28.08.2023

Numri i dokumentit: 04621778

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Rev.nr.126/23, datë 07.08.2023

**Kryetar i kolegjit  
Rrustem Thaqi**